



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 9 /2026
Datë: 16.01.2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), dhe nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me shtojcën 1, (pika 3) të Rregullore (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, duke u bazuar në nenin 371 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (Gazeta Zyrtare nr. 3/2013, 31.01.2013), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (Gazeta Zyrtare nr. 15/2017, 11.05.2017), si dhe në përputhje me, si dhe bazuar në nenin 5 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MD-NR. 09/2014 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat, Ushtruesi i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. PRANOHET kërkesa e Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika për përjashtimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat, Driton Govori, në shqyrtimin dhe vendosje në ankesën me nr. prot. 08-43 të datës 15.01.2026 e iniciuar nga z. Xhevahir Rrmoku ndaj Përmbaruesit Privat z. Driton Govori i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.
2. AUTORIZOHET zëvendës anëtari i Komisionit Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat, z. Sheremet Livoreka, i emëruar sipas vendimit të Ministres nr. 351/2025 dt. 01.08.2025, për shqyrtim dhe vendosje në ankesën vendosje me nr. prot. 08-43 të datës 15.01.2026 e iniciuar nga z. Xhevahir Rrmoku ndaj Përmbaruesit Privat z. Driton Govori, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

4. Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

Arsyetim

Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika me datën 15.01.2026 nga z. Xhevahir Rrmoku ka pranuar ankesë me nr. protokolli 08-43 për fillimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat Driton Govori, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Pas, pranimit të kësaj ankese Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika, konstatoj se subjekt i ankesës është Përmbaruesi Privat Driton Govori, i cili sipas Vendimit të Ministres nr.351/2025 është anëtarë i Komisionit Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat. Prandaj, Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika konform dispozitave dispozitave ligjore ka kërkuar përjashtimin e këtij anëtar nga shqyrtimi dhe vendosja mbi këtë ankesë me arsyetimin se ndaj të njëjti është iniciuar procedurë disiplinore.

Ushtruesi i Detyrës së Ministrit pasi shqyrtoj kërkesën bëri shikimin në shkresat e lëndës dhe duke i analizuar në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore gjeti se kërkesa është e bazuar dhe vlerëson se përjashtimi i anëtarit të Komisionit Disiplinor në lidhje me këtë rast do të ndikoj pozitivisht në rritjen e besimit të palët për objektivitetin e Komisionit Disiplinor.

Andaj bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Blerim SALLAHU

Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Kryesuesit dhe Anëtarëve të Komisionit,
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Përmbaruesit Privat,
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika,
- Odës së Përmbaruesve Privat;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.